


Nuk ka diplomë pa lidhje: Deklarata e shprehjes së vullnetit "KAoA-kompakt"

Të dashura nxënës,

për një të ardhme të sigurt, ku mund ta fitoni vetë financimin e jetë suaj, rëndësi të veçantë ka një orientim i suksesshëm i profesionit dhe studimit, si dhe zgjedhja vijuese e profesionit. Në shkollat e Nordrhein-Westfalen-it (Vestfalia e Rinit Verior) orientimi i profesionit dhe studimit është një pjesë përbërëse e mësimit në kuadër të projektit të landit "Kein Abschluss ohne Anschluss" (KAoA). (Nuk ka diplomë pa lidhje). Kalimi nga shkolla në profesion po përmirësohet sistematikisht në shkollat e landit Nordrhein-Westfalen me pjesëmarrjen e ministrive, komunave, sektorit ekonomik, sindikatave dhe Zyrës Federale të Punësimit (Bundesagentur für Arbeit) (për më shumë: "Filmi shpjegues i KAoA" në www.berufsorientierung-nrw.de).

Si të rinj që keni migruar kohët e fundit dhe që po merrni mësim në kolegjet profesionale në klasat ndërkombëtare mbështetëse ose në klasën e 10-të të një shkolle të përgjithshme, ju mund të merrni pjesën në KAoA-kompakt. Kjo masë ju mbështet gjatë zgjedhjes së një formimi profesional ose të një dege studimi dhe përbëhet nga komponentët e mëposhtëm që zhvillohen në këtë vit akademik:



Para dhe pas çdo komponenti ju do të merrni konsulencë në shkollë. Kjo konsulencë është pjesë e pandashme e programit KAoA dhe ofrohet nga ofruesi i trajnimit, i cili kryen analizën potenciale, eksplorimet e fushave të profesionit dhe kursin e praktikës.

Analiza e potencialit është komponenti i parë dhe ju jep informacion në lidhje me pikat tuaja të forta dhe potencialet. Ajo jua bën më të lehtë që gjatë procesit të mëtejshëm të orientimit të profesionit të eksploroni fushat e përshtatshme të profesionit dhe të kërkonti vendet e praktikës. Pikat tuaja të forta dhe potencialet vëzhgohen edhe gjatë eksplorimeve të fushave të profesionit dhe gjatë trajnimit praktik. Rezultatet e vëzhgimeve do t'ju bëhen të ditura dhe do t'ju ndihmojnë në marrjen e vendimit se cili profesion ju intereson dhe cilat rrugë formimi profesional planifikoni. Rezultatet e vëzhgimeve përdoren në shkollë vetëm për të mbështetur procesin e mëtejshëm të orientimit nëpërmjet bisedave të konsulencës. Ato nuk ruhen, nuk transferohen më tej dhe nuk

përdoren për qëllime të tjera. Ato nuk përfshihen në vlerësimin e notave dhe nuk kanë asnjë ndikim në statusin e lejes së qëndrimit tuaj.

Në raste të veçanta mund të ndodhë që punonjës të zyrave komunale të koordinimit ose administrata e shkollës të kryejnë vizita në formën e marrjeve të kampionëve. Këto mikpritje i shërbejnë vetëm qëllimit për të siguruar cilësinë e programit KAoA. Ato kontrollojnë vetëm mënyrën se si zbatohet kjo masë në mënyrë organizative nga ana e ofruesve të trajnimit. Pas njoftimeve paraprake mund të ndodhë që të ketë mikpritje të personelit shkencor shoqërues për të vlerësuar masën KAoA. Është siguruar që këta punonjës nuk grumbullojnë të dhënat tuaja personale.

Në mënyrë që ofruesit e caktuar të jenë në gjendje që ta përlogarisin kë të masë, krijohen lista nënshkrimet në të cilat duhet të futet nga ana juaj mbiemri, emri, seksi dhe datëlindja juaj. Ofruesit kanë detyrimin që t'i përdorin të dhënat e ruajtura vetëm për përlogaritje me "Landes-Gewerbeförderungsstelle des nordrhein-westfälischen Handwerks e.V. (LGH)" (Instituti i mbështetjes së industrisë të profesioneve të specializuara të landit Nordrhein-Westfalen). Pas përlogaritjes te ofruesi nuk mbetet më asnjë e dhënë e juaja personale.

Grumbullimi i të dhënave mund të ndodhë vetëm me pëlqimin tuaj. Ky pëlqim mund të anulohet në çdo kohë. Anulimi për këtë duhet të përmbajë një sqarim kundrejt shkollës.

Nëse nuk jepni pëlqimin, atëherë merrni pjesë në një ofertë tjetër për orientimin e profesionit.

✂-----

Deklarata e dhënies së pëlqimit "KAoA-kompakt"

Kam marrë përshkrimin e shkurtër të ofruesit dhe jam vënë në dijeni _____ në lidhje me ecurinë e analizës së potencialit, eksplorimet e fushave të profesioneve dhe trajnimit praktik dhe me anë të kësaj, jap pëlqimin tim për pjesëmarrjen në "KAoA-kompakt":

Mbiemri, Emri i nxënëses/nxënësit

Klasa _____

Vendi, data nënshkrimi